



ME EMRIN E ALL-LLAHUT, MËSHIRUESIT, MËSHIRËBËRËSIT!

Abdullah ibën Faraxh, *rahimehullah*, thotë se kishte patur nevojë për një njeri që do t'i ndihmonte rreth punëve të shtëpisë, të cilin do ta paguante me mëditje. Dhe shkoi në treg, ku e pa një djalë të ri me fytyrë të zbehur që kishte veshur një këmishë prej lesi të cilën e mbante të shtërnguar me një rryp të leshtë, kurse në dorën e tij mbante një shportë dhe një tërkuzë. Abdullahu e pyeti se a do të kishte dëshirë të punojë. Djaloshi tha po, dhe kërkoi që ta paguajë një dirhem dhe një danik (1/4 e dirhemit). Djaloshi po ashtu përcaktoi se do ta ndal punën dhe do të përgatitet për namaz kur të thërret ezani i drekës, po ashtu edhe për në ikindi.

Abdullahu u pajtua dhe e mori në shtëpinë e tij ku i tregoi se çfarë duhej të bënte. Djali punoi mirë dhe nuk tha asnjë fjalë deri sa thirri ezani i drekës. Ia përkujtoi Abdullahut marrëveshjen. Abdullahu i tha që mund të shkonte. Djaloshi shkoi e fali namazin e drekës dhe punoi deri në ikindi. Shkoi e fali edhe namazin e ikindisë, u kthye prap dhe punoi deri në fund të ditës. Abdullahu ia dha rrogën dhe djaloshi shkoi.

Pas disa ditësh, Abdullahu kishte nevojë që të kryeshin edhe ca punë në shtëpinë e tij. Gruaja e

tij e këshilloi që ta merr po atë djaloshin, sepse ishte i mirë dhe i sinqertë. Abdullahu vajti që ta kërkoi djaloshin, por nuk arriti ta gjejë. Duke e kërkuar, njerëzit tjerë i treguan se djaloshi punon vetëm të shtuneve dhe se ishte njeri i vetëm. Abdullahu priti të vinte dita e shtunë dhe e gjeti djaloshin. Djaloshi u pajtua që të punojë me kushtet e njëjta. Në fund të ditës, Abdullahu deshi që ta paguante më shumë, kurse djaloshi u hidhërua dhe iku. Abdullahu vrapoi pas tij dhe e luti që të pakën ta merr atë për të cilën ishin dakorduar. Ai pranoi dhe shkoi.

Pas pak kohe, Abdullahu përsëri kishte nevojë për djaloshin, priti të vjen dita e shtunë dhe shkoi në treg, por kësaj radhe nuk mundi ta gjejë djaloshin. Dikush i tha se djaloshi shpenzonte nga një *danik* për çdo ditë, por këtë herë ishte sëmure rëndë. Abdullahu mori vesh se ku jeton ai dhe shkoi për ta vizituar. Ai qëndronte në shtëpi me një grua plakë. Ai e vërejti djaloshin i cili flinte, kurse kokën e kishte mbështetur mbi një tullë.

- A ke nevojë për diçka? - pyeti Abdullahu.

- Po, - u përgjey djaloshi, - nëse pranon!

- Pasi që të vdes, - vazhdoi djaloshi, "shite tërkuzën time, laje këmishën dhe rrypin tim dhe pastaj më varros me ato. Shih, në xhepin tim ka një unazë. Prit deri atë ditë kur Harun el-Rashidi (halifeja i asaj kohe) të vijë në vendin tonë, qëndro në ndonjë vend ku do të mund të vërehej ai dhe pastaj afrohu dhe tregoj unazën. Por këtë bëje pasi që të më varrosësh mua". Abdullahu u pajtua.

Kur vdiq djaloshi, Abdullahu veproi ashtu siç

kishte kërkuar ai. Kur në atë vend erdhi Harun el-Rashidi, ai shkoi ta sheh atë, i tregoi se kishte besim në të dhe ia tregoi unazën. Haruni e ftoi Abdullahun të shkon tek shtëpia e tij, kur Abdullahu shkoi atje, Haruni kërkoi që çdokush që ishte prezent të largohet, dhe e pyeti Abdullahun se kush ishte ai dhe kush ia kishte dhënë atë unazë. Abdullahu iu përgjigj pyetjeve të tij. Kur Haruni dëgjo tregimin e gjatë filloi të qajë aq shumë sa që Abdullahut i erdhi keq për të.

- O udhëheqës i bësimitarëve, - iu drejtua Abdullahu halifes, Kush ishte ky djalosh?

- Djali im! - u përgjigj Haruni.

- Por si ka ndodhur që të jetë ashtu?

- Ai lindi para se të më jepej besimi për halife. Është rritur me kujdes, dhe ka qenë shumë mirë i edukuar në Kur'an dhe në lëmi tjera. Pasi që e mora halifat, ai iku dhe nuk brengosej fare për të mirat e kësaj bote. Ishte tepër i lidhur me nënën e tij dhe unë ia dhashë asaj këtë *safir* të çmuar që t'ia jep atij. Ai e pranoi më mosdashje. Nëna e tij ka ndërruar jetë, dhe që atëherë ti je i vetmi që më ka informuar në lidhje me të. Sonte do të më dërgosh tek varri i tij.

Abdullahu e dërgoi Harunin tek varri i djalit të tij. Haruni qau një kohë të gjatë dhe ngeli aty deri në agim. Haruni kërkoi që Abdullahu të qëndron aty për disa ditë që të mund të shkojnë te varrezat gjatë netëve.

Abdullahu nuk dinte se ai ishte djali i Harunit përderisa nuk i tregoi Haruni vetë.

Marrë nga libri: *Si ta përfitonin zemrën e bashkëshortes suaj*
Të autorit: Ibrahim ibën Salih el-Mahmud
Botuar nga Klubi Studentor

Një baba që i lutet Zotit për t'i dhënë vajzës së tij një burrë të ditur

Shejh Salih Ebu El-Kasim El-Haraz Es-Sufi El-Bagdadi ka thënë se ka dëgjuar El-Kadi Ebu Bekër Muhammed Bin Abdulbaki Muhammed El-Bezar El-Ensariun të thotë: “Një ditë isha afër Mekkes dhe më kishte marrë një uri e madhe dhe nuk kisha asgjë për të ngrënë. Gjeta një qese prej mëndafshi që ishte e lidhur po me një xhufkë mëndafshi dhe e mora me vete në shtëpi. Kur e zgjidha xhufkën e qeses prej mëndafshi, gjeta në të një gjerdan me margaritarë, të cilat nuk i kisha parë kurrë më parë. Kur dola jashtë, pashë një plak që po e kërkonte atë qese dhe në dorë kishte një leckë me 500 dinarë dhe po thoshte: “Këto para janë për atë që ma kthen mua qesen me margaritarë”. Mendova: “Unë jam nevojtar dhe i uritur... Përse të mos i marrë këto para që do më hyjnë në punë dhe t'ia kthej atij plakut qesen e tij?”

- “Hajde me mua, - i thashë”. E çova në shtëpi dhe ai po më përshkruante qesen, mënyrën se si e kishte lidhur, margaritarët dhe numrin e tyre. Ia dhashë dhe ai më dorëzoi 500 dinarët, mirëpo unë refuzova dhe nuk i mora. Megjithëse ai këmbënguli që të m'i jepte, unë nuk i pranova. Kështu ai u largua.

Kaluan disa kohë dhe unë u nisa me varkë përmes detit. Rrugës deti u trazua dhe barkën me gjithë njerëz i përpiu deti me gjithë ç'ka kishin me vete. Unë u kapa pas një pjese të barkës dhe qëndrova për një kohë në det i kapur pas saj. Isha tmerruar dhe nuk e dija ku po shkoja.

Kaluan disa orë dhe e pashë veten buzë një ishulli. U gëzova shumë. Zbrita dhe u takova me disa njerëz që jetonin atje. Qëndrova në disa xhami dhe njerëzit më respektonin shumë pasi unë u mësoja atyre Kur'anin. Ata më kërkuan t'u mësoja fëmijëve të tyre shkrim e këndim dhe kështu bëra. Më dhanë shumë pasuri dhe e ndjeja veten prej tyre. Një ditë disa prej tyre më thanë: “Kemi një vajzë jetime që nuk është keq nga gjendja ekonomike dhe duam ta martojmë me ty”.

Fillimisht kundërshtova, por kur e pashë insistimin e tyre, pranova. Kur e pashë atë vajzë, vura re se ajo kishte të varur në qafë gjerdanin që kisha gjetur dikur. E ngula shikimin në atë gjerdan dhe u shtanga. Ata që ishin afër më thanë: “Ç'ke që ia ke ngulur shikimin gjerdanit të kësaj vajze dhe nuk po e vështron atë fare?”

Ua tregova historinë e gjerdanit dhe ata u mahnitën shumë.

- “Mirë unë, po ju ç'keni? - u thashë”.

- “E di si është puna? - më thanë. - Plaku, të cilit ti ia ke gjetur gjerdanin është babai i kësaj vajze. Ai gjithmonë thoshte se nuk kishte parë njeri më të mirë se ai që i kishte kthyer gjerdanin. Ai lutej vazhdimisht duke thënë: “O Zot! Më bashko mua me atë burrë dhe bëj që ai të martohet me vajzën time!”

Kështu u martova me atë vajzë dhe pata me të dy fëmijë. Pas disa kohësh ajo vdiq dhe unë bashkë me fëmijët trashëguam gjerdanin e saj. Më pas e shita atë gjerdan për 100 mijë dinarë dhe pasuria që ju shihni është pjesë e atij gjerdani”.

Përktheu: Agim Abazi

KLUBI STUDENTOR

Pasi të lexoni këtë broshurë, mundësojani të tjerëve të lexojnë të njëjtën. Dhe keni kujdes, fletushka përmban ajete kur'anore, andaj ndalohet hyrja me të në vende të ndotura, gjegjësisht në toalet si dhe në vende të ngjashme.

Boton:
Shoqata Qytetare
Klubi Studentor

e-mail: penastudentore@hotmail.com

